



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.

Tiranë ____/____/2025

Nr. Dok. 202503645/2

Lënda: Rekomandim për inspektimin e kryer në Shtëpinë e të Moshuarve në
Gjirokastrë.

Drejtuar: Znj. Evis SALA
Ministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

TIRANË

Znj. Reme XHOLI
Drejtoreshë e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror

TIRANË

Z. Flamur GOLEMI
Kryetar i Bashkisë

GJIROKASTËR

Znj. Dorianë DEMO
Drejtoreshë e Shtëpisë së të Moshuarve

GJIROKASTËR

Të nderuar,

Avokati i Popullit, Ju falenderon për bashkëpunimin e deritanishëm dhe vlerëson angazhimin dhe punën e të gjithë stafit të institucionit që ju drejtoni, si dhe frymën e mirë të bashkëpunimit dhe mirëkuptimit midis institucioneve tona.

Në vijim po ju njohim mbi monitorimin që institucioni i Avokatit të Popullit kreu në institucionin tuaj.

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimit ose Dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar (MKPT), seksion pranë

Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, inspektoi Shtëpinë e të Moshuarve Gjirokastrë, më datë 14.10.2025 sipas Planit të Inspektimit për vitin 2025 të miratuar nga Avokati i Popullit.

Në përbërje të grupit inspektues ishin znj. Lindita Dedëgjoni, z. Vullnet Topalli dhe z. Hazbi Selita me detyrë ndihmës komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar.

Qëllimi i këtij inspektimi ishte:

- 1- Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së këtij shërbimi, ndjekja e rekomandimeve të lëna nga inspektimet e mëparshme nga institucioni i Avokatit të Popullit dhe masat e marra për zbatimin e tyre, mbledhjen e informacionit lidhur me kushtet dhe trajtimin e të moshuarve;
- 2- identifikimi i rasteve të mundshme të përdorimit ndaj të moshuarve të akomoduar në qendër të presionit psikologjik dhe përdorimin e forcës fizike tej kufijve në tejkalim të standardeve, apo dhe mbajtjen në qendra rezidenciale pa vullnetin e tyre.

Avokati i Popullit, pasi shqyrtoi informacionin nga monitorimi i realizuar, ka detyrimin ligjor, t’ju parashtojë përfundimet e këtij monitorimi.

Metodologjia

Grupi i inspektimit i përbërë nga një mjeke dhe dy juristë si metodologji pune ka përdorur:

- ***Së pari***, zhvillimin e bisedave paraprake me përgjegjësen e sektorit social, informacion, i cili është hedhur në një formular standard për inspektimin.
- ***Së dyti***, monitorimin e zbatimit të standardeve ligjore të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për qendrat rezidenciale për të moshuarit, sipas Udhëzimit nr. 168, datë 29.03.2024 "Për miratimin e standardeve të shërbimit të përkujdesit shoqëror për të moshuar në qendrat rezidenciale dhe manuali i zbatimit”.
- ***Së treti***, monitorimin e mjediseve dhe kushteve të institucionit (Shtëpia e të Moshuarve në Gjirokastrë) ku ofrohen shërbime për personat e moshuar.
- ***Së katërti***, komunikimi individual dhe konfidencial me disa të moshuar, përfitues të shërbimeve të përkujdesjes, të akomoduar në Shtëpinë e të Moshuarve në Gjirokastrë.
- ***Së gjashti***, vlerësimi i dokumentacionit mbi të cilin Shtëpia e të Moshuarve Gjirokastrë zhvillon aktivitetin.

Rekomandimet e vitit 2024 dhe niveli i zbatimit të tyre

Në përgjigje të rekomandimeve të Avokatit të Popullit¹ për problemet e konstatuara nga inspektimi i mëparshëm i kryer datë 11.10.2024 në Shtëpinë e të Moshuarve në Gjirokastrë, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror ka informuar²

- Lidhur me rekomandimin për marrjen e masave të menjëhershme për shtimin e organikës me një psikolog dhe një mjek me kohë të plotë, si dhe për shtim të numrit të stafit me një fizioterapist, sqarojnë se Shërbimit Social Shtetëror duke u bazuar në VKM nr. 135 datë 07.03.2018, “Për miratimin e statutit të Shërbimit Social Shtetëror”, i ndryshuar, Udhëzimit nr. 168, datë 29.03.2024 “Për miratimin e standardeve të shërbimit të përkujdesit shoqëror për të moshuar në qendrat rezidenciale dhe manuali i zbatimit” si dhe nisur nga nevojat e institucioneve të përkujdesit shoqëror për përmirësimin e shërbimeve të ofruara, ka dërguar shkresën nr. 2448/1 prot. datë 22.04.2024 “Kërkesë për rishikimin e strukturave organizative të institucioneve të përkujdesit shoqëror për të moshuar”, pranë Bashkive Poliçan, Fier, Gjirokastrë dhe Kavajë për të sjellë ndryshimet apo propozime të strukturës për institucionet e përkujdesit shoqëror për të moshuar, në mënyrë që shërbimi në këto institucione mos të ketë mangësi.
- Lidhur me rekomandimin për marrjen e masave për krijimin e një ambient terapeutik për përdorim jo vetëm për kategorinë e të sëmurëve, por edhe për të moshuarit e tjerë, SHSSH sqaron se Shtëpia e të Moshuarve në Gjirokastrë është në administrim të Bashkisë Gjirokastrë dhe SHSSH alokon fonde vetëm për paga, sigurime shoqërore dhe shpenzime operative. Kërkesat për investime duhet t’i drejtohen Bashkisë Gjirokastrë.
- Lidhur me rekomandimin për marrjen e masave **për ngritjen e një qendre socio- sanitare**, ku trajtohen me përkujdesje të moshuarit me probleme të rënda shëndetësore sqarojnë se Shërbimi Social Shtetëror ka realizuar një analizë të numrit të kërkesave të të moshuarve për sistemimin në institucionet rezidenciale për të moshuar, kërkesat për sistemime në vitet paraardhëse, numrit të kapaciteteve në qendrat e përkujdesit për të moshuar, diagnozat e të moshuarve në institucionet rezidenciale etj. Shërbimi Social Shtetëror³ i është drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për të ngritur një shërbim të ri për të moshuarit jo- autosuficientë.
- Lidhur me rekomandimin për pajisjen e Shtëpisë së të Moshuarve Gjirokastrë me shtretër të përshtatshëm dhe të dedikuar për kategorinë e të

¹ Rekomandim Nr. K4/I79-2 prot, datë 23.12.2024, “Rekomandim për inspektimin e kryer në Shtëpinë e të Moshuarve në Gjirokastrë

² Shkresa me nr. 10011/1 prot., date 10.01.2025

³ Shkresa nr. 2741, datë 08.04.2025, “Dërgim informacioni mbi Shtëpitë e të moshuarve dhe nevojën e ngritjes së një shërbimi të ri për të moshuarit jo autosuficientë”.

moshuarve me probleme të rënda shëndetësore, SHSSH sqaron se Shtëpia e të Moshuarve në Gjirokastrë është në administrim të Bashkisë Gjirokastrë dhe SHSSH alokon fonde vetëm për paga, sigurime shoqërore dhe shpenzime operative. Kërkesat për investime duhet t'i drejtohen Bashkisë Gjirokastrë.

Bashkia Gjirokastrë **nuk ka** kthyer përgjigje për rekomandimet e Avokatit të Popullit.

Lidhur me zbatimin e rekomandimeve, rezultoi se janë realizuar 2 nga rekomandimet e Avokatit të Popullit, ndërsa janë pranuar por nuk janë realizuar 4 nga rekomandimet e lëna në inspektimin e mëparshëm, konkretisht:

1. **Nuk** ishin marrë masa për shtimin e organikës me një psikolog dhe një mjek me kohë të plotë, si dhe për shtim të numrit të stafit me një fizioterapist.
2. **Nuk** ishin marrë masa për të krijuar një ambient terapeutik për përdorim jo vetëm për kategorinë e të sëmurëve, por edhe për të moshuarit e tjerë.
3. **Nuk** ishin marrë masa për ngritjen e një qendre të re socio-sanitare për trajtimin me përkujdesje të moshuarit me probleme të rënda shëndetësore.
4. **Nuk** ishin marrë masa për pajisjen e Shtëpisë së të Moshuarve Gjirokastrë me shtretër të përshtatshëm dhe të dedikuar për kategorinë e të moshuarve me probleme të rënda shëndetësore.

Rekomandimet e zbatuara janë:

- ✓ Ishin marrë masat nga institucioni për eliminimin e lagështirës në ambientet e institucionit.
- ✓ Ishin marrë masat për ruajtjen e kampionëve ushqimor me etiketa sipas standardeve.

Shtëpia e të Moshuarve Gjirokastrë funksionon në varësi të Bashkisë Gjirokastrë dhe Shërbimit Social Shtetëror, prandaj është e domosdoshme që këto institucione të marrin përgjegjësinë për trajtimin e plotë të rekomandimeve të lëna nga institucioni ynë.

Megjithatë Shërbimit Social Shtetëror i është përgjigjur rekomandimeve të Avokatit të Popullit, është e nevojshme që këto rekomandime të adresohen në mënyrë të strukturuar dhe nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe në

bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror të hartojnë një plan veprimi konkret, në mënyrë që të mos shmangen përgjegjësitë.

Gjithashtu Avokati i Popullit vlerëson se institucioni duhet të ketë buxhet të mjaftueshëm për të përmirësuar kushtet e jetesës dhe ato infrastrukture, me qëllim garantimin e të drejtave të njeriut dhe përmirësimin e standardeve të përkujdesit shoqëror për të moshuarit në qendrat rezidenciale. Avokati i Popullit nënvizon se financimi i pamjaftueshëm i qendrave rezidenciale për të moshuarit dëmton të drejtën e tyre për një trajtim të përshtatshëm dhe mund të përbëjë shkelje të standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare për kujdesin social. Avokati i Popullit vlerëson se menaxhimi i Shtëpisë së të Moshuarve Gjirokastrë në nivel lokal dhe kalimi i kompetencave Bashkisë Gjirokastrë nuk është në përputhje me përgjegjësitë që kjo e fundit ka për këto qendra.

Gjithashtu Komiteti për Parandalimin e Torturës në Këshillin e Evropës (KPT) gjatë vizitës së tij në Shqipëri në 4-15 Maj 2023, vizitoi disa nga shtëpitë e kujdesit shoqëror, (kategori në të cilat bëjnë pjesë edhe shtëpitë e të moshuarve) dhe në raportin datë 24 nëntor 2023, me rekomandime drejtuar Qeverisë Shqiptare, ka shprehur edhe një herë rezerva në lidhje me mbështetjen e pamjaftueshme financiare nga autoritetet qeveritare duke theksuar se: *“shtëpitë e kujdesit shoqëror, qofshin të financuara nga shteti, rajoni, bashkia ose tjetër, duhet të vendosen në një pozicion financiar për t’u ofruar banorëve kujdes thelbësor dhe strehimin e duhur pa pasur nevojë të kërkojnë burime të jashtme si donatorët privatë ose publikë”*.

Gjetjet e evidentuara përgjatë inspektimit

1) Profili i Shtëpisë së të Moshuarve, Gjirokastrë

Shtëpia e të Moshuarve Gjirokastrë, është një institucion publik rezidencial, ku trajtohen persona të moshuar, të cilët kanë mbushur moshën për pension pleqërie, sipas legjislacionit në fuqi.

Misioni i këtij institucioni është që të ofrojë ndihmë dhe shërbime sociale të qëndrueshme dhe me standarde bashkëkohore, me qëllim që të nxitet pavarësia dhe integrimi i të moshuarve në jetën normale, duke bashkëpunuar me shoqërinë civile, komunitetin, biznesin, me synim plotësimin e nevojave sociale dhe përmirësimin e cilësisë së jetesës së të moshuarve.

Shtëpia e të Moshuarve Gjirokastrë është nën administrimin e Bashkisë Gjirokastrë dhe gëzon mbështetje financiare të garantuar nga programet e mbrojtjes sociale të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nëpërmjet Shërbimit Social Shtetëror. Ky institucion është përgjegjës për mbarëvajtjen e punës dhe raporton në

mënyrë periodike në Shërbimin Social Shtetëror dhe Bashkinë Gjirokastrë, përsa i përket buxhetit, zbatimit e projekteve, menaxhimit e ndihmave humanitare nga donatorë të ndryshëm, si dhe paraqitjen e informacionit statistikor.

Shtëpia e të Moshuarve Gjirokastrë, ofron shërbime sipas standardeve të miratuara për personat e moshuar, të cilët janë të vetmuar dhe të braktisur, sipas verifikimeve të kryera nga punonjësi social në njësinë e qeverisjes vendore për vlerësimin dhe referimin e rastit dhe që kanë nevojë për kujdes të vazhdueshëm.

Zbatimi i standardeve të ofruara të shërbimeve sociale, si një proces vazhdueshëm, monitorohet nga Bashkia Gjirokastrë, Shërbimi Social Shtetëror, Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Gjirokastrë, nga inspektimet e kryera të Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, Drejtorisë së Shëndetit Publik, Agjencisë Kombëtare të Ushqimit etj.

2) Numri i përfituesve nga shërbimet e ofruara

Në Shtëpinë e të Moshuarve Gjirokastrë akomodohen dhe ofrohen shërbime për persona të moshuar, mbi moshën 60 vjeç për gra dhe 65 vjeç për meshkuj.

Kapaciteti i institucionit për ofrimin e shërbimeve është për një numër maksimal prej 60 persona.

Gjatë inspektimit u evidentua se në këtë institucion trajtoheshin 57 të moshuar, nga të cilët 21 gra dhe 36 burra. Pjesa më e madhe e të moshuarve janë me probleme shëndetësore, 30 prej të cilëve janë të sëmurë kronik dhe 3 të moshuar janë të sëmurë paraplegjikë e tetraplegjikë dhe 6 të moshuar kanë vështirësi në ecje. Në qendër ishin 12 të moshuar me probleme të shëndetit mendor dhe 40 të moshuar nuk kryejnë vetëshërbime, të cilët kërkojnë kujdes të veçantë.

Grupmosha mbi 75 vjeç përbën rreth 35% të të moshuarve të akomoduar në këtë qendër, nga kjo grupmoshë ishin 20 të moshuar. nërkohë grupmosha 60-70 vjeç, 25 të moshuar dhe nën 60-vjeç ishin të akomoduar 12 të moshuar.

Përfitues të pensionit të pleqërisë janë 33 të moshuar, nga i cili 60% ju jepet vetë personave ndërkohë që 40% shkon në buxhetin e shtetit⁴. Përfitues të ndihmës ekonomike janë 15 të moshuar, ndërsa 9 të moshuar nuk përfitojnë asnjë lloj pensioni apo ndihmë ekonomike, të cilët janë persona që nuk kanë mbushur moshën e pensionit dhe vuajnë nga problematika të ndryshme.

⁴ Bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. Nr.898, datë 10.11.2010, "Për disa ndryshime në Vendimin nr.114, datë 31.1.2007 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e masës së kontributeve të personave që vendosen në institucionet rezidenciale publike të përkujdesit shoqëror".

Nga informacioni i marrë për periudhën Janar-Tetor 2025 rezulton se:

- Janë larguar nga qendra në shtëpitë e tyre 1 i moshuar;
- Kanë ndërruar jetë nga shkaqe natyrore 13 të moshuar, përfshirë 6 persona grupmosha 65-75 vjeç, 4 persona grupmosha 75-85 vjeç 3 persona grupmosha 85-95 vjeç;
- Kanë ardhur 17 të moshuar të rinj, nga të cilët 14 të moshuar nga ShSSH dhe 3 të moshuar nga Bashkia Gjirokastrë.

Për çdo përfitues të shërbimeve të këtij institucioni ishte hartuar një plan për kujdesin shëndetësor, sipas nevojave specifike për secilin të moshuar, bazuar në kartelën shëndetësore, e cila mbahet mbahen në infermieri nga mjekja. Plani i kujdesit shëndetësor hartohet çdo muaj nga mjekja, e cila prej vitesh punon me kohë të pjesshme në këtë institucion, e cila çdo ditë i takon të moshuarit, i mat tension dhe bisedon me ta për çdo problem që ata i shqetëson. Gjithashtu të gjithë të moshuarit kishin të pasqyruar në kartelat e tyre dhe analizat klinike dhe biokimike.

Plani i përkujdesit për të moshuarit hartohet çdo vit, ndërsa rishikohej ecuria e të moshuarit çdo 6 muaj. Nëse konstatoheshin probleme më specifike, plani i përkujdesjes rishikohej edhe më herët se afati 6 mujor i përcaktuar.

Në ditën e inspektimit në qendër ishin 12 të moshuar me probleme të shëndetit mendor. Numri i lartë i personave me probleme të shëndetit mendor, rreth 20% e të moshuarve, si dhe mungesa e një Psikologu apo një mjeku Psikiatër në qendër, krijon vështirësi në ofrimin e shërbimeve mjekësore dhe psiko-sociale duke përfshirë konsultat mjekësore të specializuara dhe terapitë rehabilituese.

Shërbimi Social Shtetëror duhet të shqyrtojë mundësinë e sistemit të personave të moshuar me probleme të rënda të shëndetit mendor në një institucion ku mund të marrin kujdesin e duhur profesional.

Avokati i Popullit ka rekomanduar në mënyrë të përsëritur që për të garantuar mirëqenien dhe sigurinë e të gjithë banorëve, SHSSH të hartoj një strategji për sistemin e të moshuarve me probleme të shëndetit mendor në qendra rajonale të përshtatshme, ku të kenë mbështetje të vazhdueshme nga stafi i specializuar.

Ngritja e qendrave rajonale synon ofrimin e kujdesit të specializuar për të moshuarit që vuajnë nga çrregullime të shëndetit mendor, duke garantuar trajtim dinjitoz dhe mbështetje afatgjatë, për të mundësuar akses më të lehtë në shërbimet psikosociale dhe psikiatrike për të moshuarit.

Qendrat rajonale duhet të punësojnë profesionistë të trajnuar në gerontopsikiatri, psikologji klinike dhe terapi rehabilituese, për të ofruar kujdes gjithëpërfshirës.

Medikamentet, me të cilat trajtoheshin të moshuarit ishin të rimbursueshme dhe u jepeshin rregullisht. Furnizimi bëhet 2 herë në vit dhe është i mjaftueshëm sipas kërkesave të të moshuarve, të cilët nuk paraqitën ankesa ndaj stafit për këtë shërbim. Gjithashtu në ambientet e infermierisë u kontrollua dhe sasia e ilaçeve që ishte në dispozicion, të cilat ishin brenda afatit të skadencës.

3) Burimet njerëzore

Personeli i kësaj qendre përbëhet nga 21 punonjës⁵ ku të gjithë ishin të kualifikuar sipas pozicionit përkatës. Theksojmë se numri i përgjithshëm i punonjësve ka ngjitur i pandryshuar edhe pas miratimit që i është bërë me Urdhër të Kryeministrit, Organikës së Shtëpisë së të Moshuarve Gjirokastër. Vlerësimi i punës bëhet çdo gjashtë muaj.

Spektori i Shërbimit Social që merret me trajtimin e problemeve psiko-sociale dhe shërbimet shoqërore përbëhet nga 1(një) punonjëse sociale dhe 5 kujdestarë me kohë të plotë ndërsa mjeku dhe një infermiere në institucion ishin të punësuar me kohë të pjesshme.

Shërbimet shoqërore të këtij institucioni rezidencial ofrohen nga 5 (pesë) kujdestarë dhe 9 (nëntë) sanitare, si më poshtë:

Gjatë turnit të parë punojnë 1(një) kujdestare dhe 4 (katër) sanitare;

Gjatë turnit të dytë punojnë 1 (një) kujdestare dhe 1 (një) sanitare;

Gjatë turnit të tretë punon vetëm 1 (një) kujdestare për të gjithë të moshuarit.

Avokati Popullit vlerëson se numri i kufizuar i kujdestareve, vetëm një për turn nuk lejon mbulimin e plotë të nevojave për shërbime të të moshuarve gjatë gjithë ditës. Për të garantuar një kujdes të pandërprerë, për të siguruar një mbështetje më të mirë për të moshuarit si dhe një përgjigje më efektive ndaj situatave emergjente, do të ishte e domosdoshme që gjatë turnit të parë dhe të dytë të kishte një numër të mjaftueshëm kujdestarësh, duke marrë parasysh dhe numrin në rritje të të moshuarve me probleme të rënda shëndetësore dhe që nuk kryejnë dot vetëshërbime.

Në këtë institucion rezidencial janë të punësuar 5 kujdestare që ofrojnë shërbime shoqërore për 57 të moshuar të akomoduar në këtë qendër. Numri i kufizuar i kujdestarëve e bën të pamundur ofrimin e një shërbimi efikas me qëllim rritjen e cilësisë së jetesës së përfituesve të kësaj qendre rezidenciale, si dhe ofrimin e një komunikim empatik për këta banorë.

⁵ Urdhër i Kryeministrit nr. 168, datë 29.09.2025, për Organikën e Shtëpisë së të Moshuarve Gjirokastër.

Nisur nga fakti që në këtë qendër përveç të moshuarve me autonomi të plotë, rreth 40% e të moshuarve të akomoduar janë me probleme të rënda shëndetësore, të paaftë fizikisht, me probleme të ecjes dhe të paaftë të kryejnë vetëshërbime për shkak të moshës dhe problemeve shëndetësore, nevojitet shtimi i numrit të kujdestareve dhe prania e infermiereve. Prania e kufizuar e stafit ishte e papajtueshme me nivelin e paaftësisë fizike të këtyre banorëve, sasinë e detyrave që duheshin kryer (ndërrimi i pelenave, ndihma në ushqyerje, ndihma në veshje dhe zhveshje, ndërrimi i çarçafëve, organizimi i aktiviteteve, etj.).

Mungesa e stafit krijon një atmosferë jo të ngrohtë e miqësore në qendër. Prania e shtuar e kujdestarëve do të ndikonte ndjeshëm në gjallërinë dhe mirëqenien emocionale të të moshuarve. Një prezencë më e gjatë e kujdestarëve dhe prania e infermierëve garanton jo vetëm mbulim më të mirë të nevojave sociale dhe shëndetësore, por edhe një ndjenjë sigurie dhe mirëqenieje për të gjithë banorët e qendrës.

Mungesa në organikë e infermierëve me kohë të plotë, si dhe mungesa e mjekut në gjysmën e ditës, e bën të vështirë ofrimin e një shërbimi shëndetësor bazik për grupmoshën e kësaj qendre. Kujdestaret infermiere në profesion nuk janë të mjaftueshme dhe personeli mbetet jo i kualifikuar në dhënien e shërbimit pasi duhet të bëjnë punë të dyfishtë duke sjellë probleme si mungesa në kontrollet e rregullta të banorëve, regjistrime jo të duhura të parametrave jetësore dhe të mjekimeve që u jepen banorëve.

Për të menaxhuar sfidat emocionale të kësaj grupmoshe dhe për të mbështetur një qasje të individualizuar në kujdesin psikosocial, si dhe qasja e tyre nëpërmjet një komunikim empatik, është konstatuar se ka nevojë për trajnime të kujdestarëve. Trajnimet ndihmojnë stafin kujdestar që të rrisin kapacitetet e tyre në shërbim të të moshuarve, duke rritur cilësinë e jetesës së përfituesve të kësaj qendre rezidenciale.

Qendra e Kurseve të trajnimit të Profesionistëve të Shëndetit “TASh” kishte organizuar në Gjirokastrë një trajnim në datat 17-18 Maj 2025, me temë “Kujdesjet e komfortit dhe të rehatisë tek pacientët jo-autonomë, nuk është luks, por jetik”.

Duke pasur parasysh natyrën sfiduese të punës së kujdestareve dhe nevojat e banorëve, është me rëndësi thelbësore që stafi kujdestar të marrë trajnim të vazhdueshëm për punën e tyre.

Me trajtimin e problemeve psiko-sociale, të përfituesve të shërbimeve të ofruara është e ngarkuar 1(një) punonjëse sociale, ndërkohë që qendra nuk ka psikologe.

Mungesa e psikologut nuk mund të mbulohet nga punonjësi psiko-social pasi roli i tij në një qendër të tillë është shumë i domosdoshëm për të siguruar edhe shëndetin mendor të kësaj kategorie.

Dosjet personale të punonjësve të kësaj qendre mbahen në institucion. Përshkrimi i punës për personelin pasqyrohet në Rregulloren e Brendshme të Shtëpisë së të Moshuarve Gjirokastrë, e miratuar nga Këshilli Bashkiak i Bashkisë Gjirokastrë.

Vlerësimi i punës së stafit bëhet dy herë në vit nga drejtuesi i institucionit.

Shtëpia e të Moshuarve Gjirokastrë për vizita të specializuara mjekësore i dërgon të moshuarit në Spitalin Rajonal Gjirokastrë dhe sipas kartelave të tyre mjekësore, ishin kryer vizita mjekësore te mjeku endokrinolog, kirurg, gastroenterolog, si dhe ishin kryer ekzaminime radiologjike, echografike dhe analiza laboratorike.

Medikamentet që marrin të moshuarit pasqyrohen në një bllok të veçantë, i cili sekretohet dhe ruhet në arshivë. Shërbimi dentar realizohet me shpenzimet e të moshuarve në raste të tilla si vënie protezash etj. Shërbimet e tjera dentare mbulohen nga institucioni. Gjithashtu vizita ishin kryer edhe te mjeku okulist, si dhe vendosje syzash optike për një banorë.

Ambientet e Shtëpisë së të Moshuarve në Gjirokastrë

Megjithëse gjendja e godinës së Shtëpisë të Moshuarve Gjirokastrë paraqitej përgjithësisht e mirë, është i pranishëm amortizimi i mobiljeve dhe pajisjeve nëpër dhomat e banorëve. Dyert e dollapëve dhe komodinave ishin të amortizuara, çka ndikon negativisht në cilësinë e jetës së banorëve.

Për të siguruar kushte të përshtatshme akomodimi dhe kujdesi për banorët e qendrës së të moshuarve, nga ana e qendrës janë marrë masa për planifikimin në buxhetin e vitit 2026, për blerjen e 2 shtretërve ortopedikë me mekanizëm, 30 shtretërve prej druri tek, 20 dollapëve me dy kanata dhe 30 komodina.

Megjithë rekomandimet e persëritura të Avokatit të Popullit për pajisjen e qendrës me shtretër të veçantë për të moshuarit me probleme të rënda shëndetësore, qendra nuk ishte pajisur ende me shtretër orthopedik.

Në ambientet e brendshme dhe të jashtme të këtij institucioni mbizotëron pastërtia, gjë që tregon për një bashkërendim të punës së Drejtuesit, stafit dhe përfituesve.

Godina është e pajisur me tualete me dush dhe lavaman, të cilat janë të vendosura jashtë dhomave në fund të korridorit, por të binte në sy që pajisjet higjeno-sanitare ishin të amortizuara. Institucioni planifikon çdo vit buxhet për pajisjet higjienike, batanije e çarçafë.

Shtëpia e të të Moshuarve Gjirokastrë, ka nevojë për një buxhet financiar të mjaftueshëm, për t'u ofruar banorëve kujdes thelbësor dhe strehimin e duhur.

Mbështetja e pamjaftueshme financiare nga Bashkia Gjirokastrë dhe Shërbimi Social Shtetëror, për investime apo dhe riparime thelbësore, blerje mobiljesh, madje edhe sendet që lidhen me kujdesin personal, si karriget me rrota, të përshtatshme për banorët dhe produktet personale, ndikon negativisht për ofrimin e shërbimeve me standarde për këta banorë.

Ambientet e përbashkëta në katin e parë dhe në katin e dytë ishin të pastra, kishin dekorime të ndryshme dhe kishte dritë të mjaftueshme natyrore.

Mjetet për shmangien e rreziqeve që mund të vijnë nga rastet e emergjencave civile, ishin të vendosura në vende të veçanta në korridore. Stafi ishte trajnuar për përdorimin e mjeteve kundër zjarrit.

Në ambientet e kuzhinës ambienti ishte i pastër, i pajisur me soba profesionale, frigorifer dhe ishte e afishuar menuja ditore. Për përcaktimin e menysë dhe oraret e vakteve të ngrënies, merrej mendimi i të moshuarve. Menuja javore firmoset nga një i moshuar, i cili mund edhe të ndryshohet po nga të moshuarit sipas preferencave. Kampionët e ushqimeve për të treja vaktet ruheshin në frigorifer dhe ishin të etiketuar.

Avokati i Popullit me qëllim që t'u sigurohet banorëve një dietë të shëndetshme dhe të larmishme, në rekomandimet e bëra ndër vite ka kërkuar rritjen e kuotës ushqimore për të moshuarit në qendrat rezidenciale.

Kuota ushqimore është rritur në 440 lekë në ditë⁶, por kjo ka qënë një rritje minimale, që nuk balancon rritjen e çmimeve të shportës dhe kjo kuotë mbetet e pamjaftueshme për të përmbushur nevojat e banorëve, sipas normës ditore të kalorive për një të rritur⁷.

Ambientet ishin të monitoruara me sistem kamerash i cili ishte funksional i përbërë nga 13 kamera. Filmimet e tyre ruhen 1 muaj dhe menaxhohen nga drejtuesi i qendrës.

Në qendër mungonin hapësirat e mjaftueshme të jashtme për shplodhje dhe qëndrim në ajër të pastër. Në katin e dytë të godinës ndodhej një tarrac, e cila ishte e parregulluar dhe nuk ofronte kushte të përshtatshme për përdorim nga të moshuarit. Ky ambient ka nevojë të restaurohet, të pajiset me mobilje të rehatshme, ndriçim adekuat dhe masa sigurie (si parrakë të përshtatshme), në mënyrë që të shërbejë si hapësirë për pushim dhe aktivitete sociale.

⁶ Urdhër i MSHMS nr. 293, datë 31.07.2025, "Për nivelin e kuatove të shpenzimeve për ushqime, në Institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesit shoqëror".

⁷ Raporti i institucionit të Avokatit të Popullit "Për Standardin e Minimumit Jetik në Shqipëri".
Tabela 10. Kostoja minimale e shportës ushqimore në Shqipëri sipas normës ditore të kalorive për 1 të rritur (vlera mujore 7427 lekë). Burimi INSTAT

Ngrohja dhe ftohja e dhomave dhe ambienteve të përbashkëta në Shtëpinë e të Moshuarve Gjirokastër realizohej me kondicionerë, pas një investimi me fondet e Bashkisë Gjirokastër.

Të moshuarit për higjienën e tyre personale bënin dush dy herë në javë.

Në çdo kat, në ambiente të veçanta ishin të afishuara rregullorja e brendshme⁸ ku parashikohen standardet që duhet të respektonin punonjësit e qendrës dhe përfituesit.

Kutia e ankesave, çelësi i së cilës mbahet nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Gjirokastër, hapet në datë 1 (një) të çdo muaji, në praninë e një të moshuari.

Furnizimi me artikuj hotelerie gjatë vitit 2025 ka qenë sipas nevojave dhe nuk ka patur mungesa.

4) Jeta social-kulturore

Përsa i përket jetës sociale, u informuam nga punonjësja sociale se organizoheshin aktivitete të ndryshme: ditëlindje, festa fetare, festat zyrtare, si dhe angazhimi i të moshuarve në punët artizanale. Gjate këtij vitit ishin organizuar dhe vizita në pikat turistike, muzeume dhe qytet.

Të moshuarit vizitohen nga të afërmit e tyre. Takimet e realizuara pasqyrohen në një regjistër të veçantë. Për të moshuarit që nuk kanë kontakte me të afërm, bëhet një punë e madhe nga stafi për të bërë të mundur kontaktimin e tyre.

Në ditën e inspektimit të moshuarit u takuan nga ana jonë në dhomat e tyre dhe zhvilluam biseda me të moshuarit, pa praninë e stafit. Nuk u paraqitën ankesa ndaj stafit. Në këtë drejtim, përkundrazi ata konfirmonin gatishmërinë e stafit për të plotësuar çdo kërkesë të tyre.

Problematikat e konstatuara:

- Konstatohet se, rekomandimet e lëna nga Avokati i Popullit, për shtesë me punonjës janë ende të pazbatuara plotësisht, gjë e cila ka sjellë vështirësi në menaxhimin e punës dhe për rrjedhojë mungesë në ofrimin e shërbimeve për të moshuarit. Urdhëri i Kryeministrit nr. 168, datë 29.09.2025, për

⁸ Urdhër i Kryetarit të Bashkisë Gjirokastër nr. 2169, datë 03.03.2023 “Rregullore e Brendshme e Shtëpisë së të Moshuarve Gjirokastër”.

Organikën e Shtëpisë së të Moshuarve Gjirokastrë, e ka lënë të pandryshuar numrin e përgjithshëm të punonjësve në Shtëpinë e të Moshuarve Gjirokastrë.

- Konstatohet se, në qendër janë të akomoduar të moshuar që janë me probleme të rënda shëndetësore dhe që nuk kryejnë dot vetëshërbimet, si rrjedhojë del e domosdoshme nevoja për të krijuar një ambient terapeutik, i cili do mund të përdoret jo vetëm për kategorinë e të sëmurëve, por edhe për të moshuarit e tjerë. Sipas rekomandimeve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, për aktivitetin fizik të të moshuarve mbi moshën 65 vjeç, “çdo aktivitet fizik vlen sado i vogël që të jetë”, do të ishte i nevojshëm punësimi i një fizioterapisti në këtë qendër.
- Konstatohet prania e 12 persona që vuajnë nga çrregullime të shëndetit mendor, të cilët bashkëjetojnë me të moshuar që kanë nevojë të veçanta për kujdesjeje, që shpesh krijon vështirësi në përditshmërinë e tyre, duke ndikuar në rehatinë dhe cilësinë e jetesës.
- Konstatohet mungesa e ambienteve argëtuese për të moshuarit e kësaj qendre.

Në përfundim të inspektimit të realizuar nga grupi i punës së Avokatit të Popullit u konkludua se duhet të adresohen të gjitha problematikat e konstatuara institucionale respektive, në nivel rekomandimesh.

Për sa më sipër, për të plotësuar standardet e përkuqdesit shoqëror për të moshuarit në institucionet rezidenciale, në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku parashikohet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”; si dhe të nenit 21, germa “b” të ligjit nr. 8454 datë. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku citohet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive,

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të menjëhershme nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Shërbimi Social Shtetëror për shtimin e organikës me një psikolog dhe një mjek me kohë të plotë, si dhe për shtim të numrit të stafit me dy kujdestarë dhe një fizioterapist.

2. Marrjen e masave nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Shërbimi Social Shtetëror për të krijuar një ambient terapeutik për përdorim jo vetëm për kategorinë e të sëmurëve, por edhe për të moshuarit e tjerë.
3. Marrjen e masave nga Bashkia Gjirokastrë që tarraca në katin e dytë të restaurohet dhe të përshtatet për përdorim nga të moshuarit, duke u pajisur me stola, mbulesa dielli dhe elementë gjelbërimi për të krijuar një ambient relaksues dhe të sigurt.
4. Marrjen e masave nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Shërbimi Social Shtetëror për sistemimin e të moshuarve me probleme të shëndetit mendor në qendra të përshtatshme, ku të kenë mbështetje të vazhdueshme nga stafi i specializuar.
5. Marrjen e masave nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Shërbimi Social Shtetëror, për bashkërendimin e punës gjatë trajtimit të rekomandimeve dhe në përgjigjen e dërguar të përcaktohet një plan konkret veprimi.
6. Marrjen e masave nga Bashkia Gjirokastrë, në koordinim të plotë me Shtëpinë e të Moshuarve Gjirokastrë, për të garantuar zbatimin efektiv me veprime konkrete, të detyrimeve të përcaktuara.

Në bazë të Nenit 22 të Ligjit Nr.8454 dt.04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar lutemi të vihem në dijeni brenda afatit 30 ditor, për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtyre rekomandimeve.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

**KOMISIONERI
i Mekanizmit Kombëtar
për Parandalimin e Torturës
(MKPT)**

Ahmet PRENÇI